

Gjykata Administrative në Leipzig, me Datë 22. Prill ka vendosur: Një Banues në një Qendër pritjeje nuk duhet të jetojë më aty. Ai mendoi, se ai nuk mund ta mbrojë vehten sa duhet kundër Virusit Korona në Qendrën e pritjes. Prandaj, ai u kthye kundër shtetit të Saksonisë. Për këtë ai bëri një Kërkesë Urgjente dhe Gjykata i dha atij të drejtë. Edhe Gjykata Administrative e Dresdenit e sheh vendimin si të duhur. Dy Gra kishin të drejtë.

Aryeja është rreziku i infektimit me Virusin Korona. Gjykatat kanë vendosur: Njerëzit duhet të strehohen në Banesa individuale. Dhe atë në atë mënyrë që ata të mund da ruajnë distancën minimale.

Ligji i Azilit thotë: Nëse Njerëzit mbërrijnë në Gjermani dhe kërkojnë azil, ata duhet të jetojnë në një Qendër pritjeje. Ligji për Azilin thotë gjithashtu: ky detyrim mund të marrë fund. Arsye mund të jenë Kujdesi shëndetësorë dhe mbrojtja nga infeksionet.

Arsyetimi i Gjykatave Administrative për vendimet është:

1. Përhapja e Virusit Korona duhet të parandalohet, dhe
2. Vetë Banori duhet të mbrohet nga infeksioni.

Në Qendrat e pritjes në Saksoni shumë Njerëz duhet të jetojnë së bashku. Banorët ndajnë dhoma, dhoma ngrënie dhe ambiente sanitare. Prandaj, nuk është e mundur të ruhet një distancë prej 1.5 m ndaj personave tjerë në hapësirat e përbashkëta dhe në ambientet sanitare.

Në Saksoni, që nga 17 Prilli i vitit 2020 është në fuqi Rregullorja për Mbrojtje kundër Koronës. Rregullorja thotë, që kontaktet me Njerëz tjerë duhet të reduktohen. Duhet përfillur një distancë prej 1,5 m karshi të tjerëve, në përjashtim të atyre me të cilët jetoni. Këto rregulla zbatohen në të gjitha fushat e jetës, pra sipas Gjykatës Administrative edhe në Qendrën e pritjes.

Përveç kësaj, Gjykata Administrative e Leipzig-ut tha: Parandalimi i përhapjes së Virusit Korona është veçanërisht i rëndësishëm në akomodimin e Azilkërkuesve. Instituti Robert Koch beson, që njerëzit të cilët pas vetes kanë një ikje fizikisht dhe psikologjikisht stresuese, e që duhet të riorientohen, kanë më shumë të ngjarë të infektohen me Virusin Korona.

Në Saksoni, përgjegjëse për strehimin e Azilkërkuesve kur të arrijnë në Gjermani është Drejtoria e Shtetit (Landit). Ajo duhet të sigurojë, që njerëzit që kanë paraqitur një Kërkesë Urgjente të zhvendosen. Për këtë një Kërkesë Urgjente duhet të jetë e suksesshme. Një Kërkesë Urgjente është e suksesshme, nëse një Gjykatë Administrative merr vendim për transferimin e një personi. Të gjithë ata, që jetojnë në Qendra të mëdha të pritjes, mund të parashtrajnë Kërkesë për akomodim të decentralizuar (Banesë).

Kjo vlenë edhe për Njësitë tjera Federale: sepse Rregulloret për Mbrojtje kundër Koronës si dhe kushtet në Qendrat e pritjes janë pothuajse çdokund të ngjashme.

Ama vini re:

- Vendimet e Gjykatave Administrative rregullojnë vetëm situatën e akomodimit për aq kohë sa Urdhëresa e Mbrojtjes kundër Virusit Korona zbatohet në Saksoni ose në Njësitë tjera federale.
- Një Kërkesë Urgjente për Mbrojtje Ligjore do të funksionojë vetëm atëherë, nëse ju paraprakisht keni parashtruar më parë një të tillë pa sukses në Drejtorinë e Shtetit (ose pranë Autoritetit Kompetent në Shtetin/Landin tuaj) [[APLIKACIONI PËR SHKARKIM I LINKUAR KËTU](#)] [[MUSTER HIER ZUM DOWNLOAD VERLINKT](#)]
- Një aplikim për rishpërndarje/transferim nuk është zgjidhja më e mirë për të gjithë: Grupet që aktualisht janë shumë të lumtura që jetojnë së bashku, por nuk janë një familje mund të ndahen.
- Personat që bëjnë një kërkesë nuk kanë asnjë ndikim se ku do të zhvendosen pasi aplikacioni të ketë qenë i suksesshëm, në cilin qytet, cilin akomodim apo apartament. Mund të jetë gjithashtu rasti që një person duhet të jetojë përsëri në akomodim të përbashkët pasi të dalë nga objekti i pritjes. Sidoqoftë, Njerëzit mund të shkruajnë në kërkesë, që duan të transferohen në një Komunë specifike. Për këtë mund të ketë arsye të mira. Për shembull, një tretman mjekësor, i cili nuk guxon të ndërpritet.
- Me gjasë aplikimi ka të ngjarë të jetë i suksesshëm vetëm për Njerëzit mbi 35 vjeç. Apo në qoftë se ekzistojnë rrethana tjera personale mjekësore si p.sh. Sëmundjet e mëparshme.

Nëse dua të parashtroj një Kërkesë Urgjente për Akomodim të decentralizuar, më nevojitet si vijon:

1. Formularin mund ta shkarkoni këtu. [[APLIKACIONI PËR SHKARKIM I LINKUAR KËTU](#)] [1. Einen Eilantrag auf dezentrale Unterbringung \(dafür gibt es eine Vorlage\)](#) [[MUSTER ZUM DOWNLOAD HIER VERLINKT](#)]

2. Vërtetimi i Vendbanimit: mjafton një kopje e pjesës së përparme dhe të pasme të Lejes së qëndrimit

3. Një Raport mbi situatën tuaj personale jetësore, në veçanti:

- Sa e madhe është Dhoma në të cilën jetoj?
- Sa Njerëz jetojnë në Dhomë?
- Sa Tualete dhe Banjo ka për sa Njerëz?
- Sa Njerëz ndajnë një Kuzhinë?
- A ka (gjithmonë) Sapun dhe Dezinfektues?

4. nëse ka: çështjet personale që janë për tu marrë në konsideratë

Nëse ju gjithashtu dëshironi të aplikoni për Ndihmë Juridike, ju nevojitet gjithashtu:

- Aplikacioni për Ndihmë Juridike
- Vendimi mbi Përfitimet e Azilkërkuetit (po qëse nuk e posedoni, mund ta merrni në Qendrën e pritjes)